



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1748 Prot.

Tiranë, më 30.10.2017

**V E N D I M**

**Nr. 218, datë 30.10.2017**

***"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 108, datë 27.04.2017, 'Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë'"***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 108, datë 27.04.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë",

**VENDOSA:**

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 108, datë 27.04.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. **Enkelejda Hebibasi**

Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve  
me Jashtë

2. **Stela Ndoka** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. **Helga Peti** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **01.11.2017 – 03.11.2017**. Nëse, gjatë fazës së përpunimit të të dhënave, lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **08.12.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **15.12.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Elbasan dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë  
22268142

Tel 04 22268141;

Nr. 1748/1 Prot.

Tiranë, 30.10.2017

**M I R A T O H E T**

**Pranvera STRAKOSHA**

**KOMISIONER**

**PROGRAM VERIFIKIMI**

***“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 108, datë 27/04/2017, ‘Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë’”.***

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Elbasan**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues Nr.108, datë 27.04.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Rregullorja *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **01.11.2017** dhe do të përfundojë më datë **03.11.2017**.

- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 1. Enkelejda Hebibasi** Drejtor, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- 6. Grupi i punës:**
- 2. Stela Ndoka** Specialist,
- 3. Helga Peti** Specialist
- 7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:** Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*nëse vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

## DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I.** Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 108, datë 27.04.2017, "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*", nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:
- 1.** *Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Elbasan, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.*
  - 2.** *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet, kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor*

për të qenë nëpunës civilë dhe për të cilët nuk është kryer deklarimi i statusit të punësimit, sipas përcaktimit të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

- o Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, duke evidentuar faktin se punonjësit e mëposhtëm nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
    1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste Rajoni nr. 5";
    2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste e Ndhmës Ekonomike";
    3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste e Ndhmës Ekonomike";
    4. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist në Sektorin e Kontrollit, në Drejtorinë e Tatim Taksave";
    5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste e Ndhmës Ekonomike";
    6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste në Arshivën Teknike, në Drejtorinë e Planifikimit e Kontrollit të Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit".
  - o Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Elbasan.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të rregullojë përmbajtjen e akteve të largimit nga detyra, në rastet, kur punonjësit nuk janë trajtuar sipas përcaktimit të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, por ata janë trajtuar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe për të cilët aktualisht, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.
- o Njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe duhet të nxjerrë një akt të ri, ku të përcaktojë se, motivacioni i daljes së aktit është mospërmbushja e kriterit të nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, pasi punonjësit e mëposhtëm kanë qenë me arsim të mesëm dhe baza ligjore për trajtimin e tyre është neni 67, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Ky akt të bëhet pjesë e dosjes së personelit për punonjësit si më poshtë:
    1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor Pyjesh/Inspektor i Mjedisit dhe M.Lulishte";
    2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Veteriner";
    3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor Buxheti/Tatim Taksave";
    4. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor Mjedisi";
    5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Veteriner";
    6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor i Ndhmës Ekonomike";
    7. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Përgjegjëse Tatim/Taksash";
    8. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Inspektor Tatim/Taksash";
    9. Ramazan Metoshi, në pozicionin e punës, "Përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit të Pyjeve Komunale";
    10. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Punonjës Kulture";
    11. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Përgjegjës Urbanistike";
    12. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Punonjëse (Specialiste) për Mbrojtjen e Fëmijëve";

13. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor Pyjesh”;
  14. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektore Finance”;
  15. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Financës”;
  16. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti”;
  17. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektore Buxheti”;
  18. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Menaxhimit Projekteve dhe e Programimit të Investimeve”;
  19. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Zyrës Tatim-Taksave”;
  20. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”;
  21. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor Kadastrë”;
  22. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor Ambjenti/Pyjesh”;
  23. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Veteriner”;
  24. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Ekonomiste”;
  25. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor i Bujqësisë dhe Tatimeve”.
4. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, që në zbatim të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosrespektimit të afatit kohor të punësimit në pozicionin e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si më poshtë:
- Për punonjësin, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të anulojë aktin nr. 277 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.
  - Për punonjësin, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të anulojë aktin nr. 276 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.
  - Për punonjësin, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist, në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të anulojë aktin nr. 338 prot., datë 19.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.
  - Për punonjësën, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektori, në Sektorin e Programeve Sociale dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Drejtorinë e Kujdesit Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të anulojë aktin nr.288 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.
  - Për punonjësin, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Administrator i Rajonit nr. 5”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të anulojë aktin nr. 664, datë 02.09.2015, për deklarimin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.

Në rastet e përmendura më sipër, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se për këta punonjës, kohëzgjatja e periudhës së punësimit është më pak se 1 vit. Në këto kushte, për të gjitha këto raste, njësia përgjegjëse duhet të kryejë edhe këto veprime sipas këtij rendi pune:

- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej, të administrohet rezultati i testimin në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimin në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

➤ Për punonjësen, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtoreshë, në Drejtorinë e Administratës e Burimeve Njerëzore”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulohet aktin administrativ nr. 278 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen \*\*\*\*\*, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit. Po kështu, të plotësojë këtë akt administrativ, duke përcaktuar kategorinë e pozicionit të punës në nivelin e mesëm drejtues, në pozicionin konkret, “Drejtoreshë në Drejtorinë e Administratës e Burimeve Njerëzore”, pasi nuk është përcaktuar shprehimisht në akt.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej, të administrohet rezultati i testimin në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).

- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).
- Të drejtojë procesin e anulimit të urdhrin nr. 1174/2, datë 18.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe të rregullojë pasojat që kanë ardhur në dëm të punonjësës, për shkak të këtij akti absolutisht të pavlefshëm.

➤ Për punonjësën, \*\*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të drejtojë procesin për të kryer veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin nr. 298 prot., datë 19.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit si “nëpunësit civil” për nëpunësen \*\*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve, në Drejtorinë e Tatim Taksave”.
- Të deklarojë statusin e punësimit si “nëpunës civil”, i konfirmuar në pozicionin “Specialist, në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, për arsye se, kjo nëpunëse, këtë pozicion pune e ka patur realisht, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).
- Të anulojë urdhrin nr. 101, datë 06.03.2014, të Kryetarit të Bashkisë, me të cilin është emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, sepse është vepruar pasi kishin filluar efektet juridike të ligjit për nëpunësin civil, në kundërshtim me kërkesat e tij, e për të njëjtën arsye, të anulojë urdhrin nr. 240, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, me të cilin nëpunësja ka kaluar në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Vlerësimit, në Agjensinë e Tatimeve e Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave”, si dhe të sistemojë punonjësën në kategorinë e pozicionit të punës, që i takon për shkak të deklarimit të statusit të punësimit.
- Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave” duhet të shpallet i lirë, për t’u plotësuar më tej, në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Elbasan.

➤ Për punonjësën, \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse duhet të veprojë për të rregulluar ligjshmërinë në dy drejtime:

a) Në lidhje me aspektin e deklarimit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili e gjeti nëpunësin në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Rregjistrimit dhe Mbledhjes, në Drejtorinë e Tatim Taksave”, njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin për të kryer veprimet sipas këtij rendi pune:



- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 281 prot., datë 13.06.2014, pasi, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se për këtë punonjës, kohëzgjatja e periudhës së punësimit është më pak se 1 vit, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej, të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsytimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

**b) Në lidhje me aspektin e procedurës së ngritjes në detyrë, për plotësimin e pozicionit të punës, “Drejtor i Auditit”, njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin për të kryer veprimet sipas këtij rendi pune:**

- Të anulohet aktin e emërimit nr. 791, datë 01.11.2014, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit”.
- Procedurat për lëvizjen paralele/ngritjen në detyrë, për pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit, duhet të rifillojnë nga e para, duke filluar me shpalljen e vendit të lirë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Elbasan.

**5. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, që në zbatim të nenit 108 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin për shkak të mospërputhjes së kualifikimit, me kërkesat e vendit të punës, si më poshtë:**

➤ Për punonjësin, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, me nr. 439, datë 17.06.2014, pasi punonjësi \*\*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, pasi nuk ka arsimin e duhur në fushën specifike.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi \*\*\*\*\*\*, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

➤ Për punonjësin, \*\*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 452, datë 17.07.2014, pasi punonjësi \*\*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, pasi nuk ka arsimin e duhur në fushën specifike.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi \*\*\*\*\*\*, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicioni i punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social” duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

➤ Për punonjësin, \*\*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 51, datë 17.07.2014, pasi punonjësi \*\*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk

*plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, pasi nuk ka arsimin e duhur në fushën specifike.*

- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi \*\*\*\*\*, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
  - *Pozicioni i punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social” duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*
- *Për punonjësen, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:*

- *Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 285, datë 13.06.2014, pasi punonjësja \*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, sipas përshkrimit të punës, në kushtet kur nuk zotëronte diplomën “Master shkencor”, në shkencat ekonomike.*
- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar faktin se, ajo nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
- *Të anulojë urdhrin nr. 727, datë 13.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë, me anë të së cilit kjo nëpunëse, ka kaluar në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, pasi ky akt ka dalë në kundërshtim me ligjin dhe me procedurat për lëvizjen paralele, ose ngritjen në detyrë, parashikuar nga nenet 25 dhe 26, të ligjit për nëpunësin civil.*
- *Pozicioni i punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

- *Për punonjësen, \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:*

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 286, datë 13.06.2014, pasi punonjësja \*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk e plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, pasi nuk ka arsimin e duhur në fushën specifike.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar faktin se, ajo nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicioni i punës, “Specialiste, në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

➤ Për punonjësin, \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës, “Drejtor i Kujdesit Social”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 332, datë 19.06.2014, pasi punonjësi \*\*\*\*\* , në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, në kushtet kur nuk zotëronte diplomën “Master shkencor”.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, ai nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicioni i punës, “Drejtor i Kujdesit Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

➤ Për punonjësen, \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës, “Specialiste, në Drejtorinë e Projektim Standartizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektmeve e Prokurimeve ”, njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 367, datë 02.07.2014, pasi punonjësja \*\*\*\*\* , në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, në kushtet kur nuk zotëronte diplomën “Master Profesional”.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar shkakun se nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e

*nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.*

- *Pozicioni i punës, "Specialiste, në Drejtorinë e Projektim Standartizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projekttimeve e Prokurimeve", duhet të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*
- 6.** *Për shkak të mosrespektimit të procedurave ligjore që rregullojnë procesin e ristrukturimit, Njësia Përgjegjëse e institucionit duhet të drejtojë procesin për kryerjen e veprimeve përkatëse, për revokimin e gjithë akteve administrative që kanë dalë deri në këtë moment në lidhje me këtë proces, në kundërshtim me ligjin dhe të fillojë procesin nga e para, duke ndjekur radhën e mëposhtme të punës:*

*a) Ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike, "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit", ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.*

*b) Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe në Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil" dhe në Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civil", të paraqesë përpara njësisë përgjegjëse, propozimet për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve është shkurtuar, apo është riorganizuar.*

*c) Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirim nga shërbimi civil, apo riemërimin në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, do të kryhet nga njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit.*

*Në këtë rast, akti i emërimit duhet të jetë nominal për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni i punës dhe kategoria e pagës.*

*Në rastet e transferimit të punonjësit për shkak të ristrukturimit, në një detyrë të një niveli më të ulët, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil".*

*d) Të hartohen dhe plotësohen përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, pasi kjo përbën një kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka për detyrë të bëjë krahasimin e kërkesave specifike të pozicioneve të punës me cilësitë dhe*

kualifikimet e çdo nëpunësi e pas kësaj të bëjë propozimin përkatës për transferimin apo lirim të secilit nëpunës.

Në rastet e lirit nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimit apo riorganizimit të vendit të punës, në aktin e lirit, të shënohen të drejtat që rrjedhin nga pikat 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil", të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta që brenda një periudhe 2 vjeçare të konkurrojë në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

7. Të kërkoj nga njësi përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, si edhe për shkak të mosrespektimit të procedurave gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit, për punonjësit e mëposhtëm:

1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve, në Drejtorinë e Tatim Taksave";
2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Administrator i Rajonit nr. 5";
3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave".
4. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Administratore";
5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor Buxheti";
6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor e Ndihmës Ekonomike";
7. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor i Ndihmës Ekonomike";
8. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor Ndihmës Ekonomike/ Inspektor Social Shtetëror, Zyra e Shërbimit Social Shtetëror";
9. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor Tatimesh";
10. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Administrator i Ndihmës Ekonomike";
11. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Inspektor i Ndihmës Ekonomike".

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për punonjësit e mësipërm, njësi përgjegjëse duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune:

Së pari, të bëjë verifikimin nëse këta punonjës i përmbushin kërkesat e posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e tyre të punësimit, si nëpunës civil, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin e tyre si nëpunës civil edhe në momentin e lirit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi;

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet t'i trajtojë këta punonjës si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të tyre në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet të zbatohet të drejtat që atyre ju takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

8. Të kërkoj nga njësi përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë gjendjen e

*paligjshmërisë lidhur me rastet e emërimeve, pa zhvilluar më parë procedurën e ngritjes në detyrë, të punonjësve që e gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në nivele më të ulëta të hierarkisë administrative në shërbimin civil.*

*Këto raste të trajtohen nëpërmjet procedurës së ristrukturimit të institucionit, sipas rëndit të punës të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicionet e punës, që do të lirohen në këto raste, fillimisht duhet të trajtohen në procesin e ristrukturimit, e nëse mbeten të lira, duhet të shpallen për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

*Për sa më sipër:*

➤ *Në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit (emërimit) nr. 885, datë 08.10.2015 dhe kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës në Sektorin e Pronave”, duhet të shpallet i lirë, për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 639, datë 31.08.2015 dhe kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Drejtor në Drejtorinë e Detyrave të Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave”, duhet të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr.160, datë 31.03.2015 dhe kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Drejtor në Drejtorinë Juridike”, duhet të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 159, datë 31.03.2015 dhe kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Asistencës Ligjore në Drejtorinë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative”, duhet të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\* , njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 1179, datë 20.11.2015 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Drejtore i Informacionit”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse duhet të anulohet aktin e transferimit nr. 374, datë 03.06.2016 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore Rinisë e Sporteve Kulturore”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësës \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse në këtë rast, duhet të anulohet aktin e transferimit nr. 422, datë 31.08.2015 dhe si në rastin e mësipërm, kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Drejtore i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Operacionale”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse, në këtë rast, duhet të anulohet aktin e transferimit nr. 779, datë 17.09.2015 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit të Territorit”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse, duhet të anulohet aktin e transferimit nr. 872, datë 12.10.2015 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

➤ *Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse duhet të anulohet aktin e transferimit nr. 82, datë 24.02.2015 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Pozicioni i punës, “Përgjegjës në Inspektoriatin e Mjedisit”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me ristrukturimin dhe strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.*

9. *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, lidhur me punonjësit e punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, pranë ish-Komunave, (sot*



Njësitë Administrative), të cilët nuk kishin dosje personale, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë në lidhje me deklarin e statusit të punësimit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Financës”,
2. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”,
3. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Veteriner/Inspektor i Zyrës së Shërbimeve”,
4. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”,
5. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor Shërbimit Pyjor, Zyra e Shërbimit Pyjor”,
6. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “P/Ndhmës Ekonomike”,
7. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor i Arsimit dhe Kulturës”,
8. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”,
9. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjës Financës”,
10. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor i Tatim-Taksash”,
11. \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Agronom”.

- Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këta punonjës, njësia përgjegjëse duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi pune: së pari, të plotësojë dosjen individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit të tyre dhe së treti, nëse punonjësit deklarojnë në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohen sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

10. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë lidhur me rastin nëpunësit civil \*\*\*\*\* . Në këtë rast, është vepruar në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që rregullojnë procesin e ristrukturimit.

- Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjës, njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 108 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet së pari, të anulojë urdhrin nr. 85, datë 24.02.2015, për largimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil \*\*\*\*\* dhe së dyti, nëse pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, konstatohet se ai gjendet në kushtet e shkurtimit të pozicionit të punës, apo mos përmbushje të kërkesave të vendit të punës, duhet të zbatohet të drejtat që atij i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke i bërë të ditur këtij punonjësi të drejtën për shpërblim financiar, në bazë të vjetërsisë në punë, si edhe të drejtën që i njeh dispozita e mësipërme ligjore për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

11. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të drejtojë procesin për anulimin nga ana e organit publik që i ka nxjerrë, të akteve të emërimit, që kanë dalë në

kundërshtim me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës.

- Në zbatim të nenit 111 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të anulojë aktet përkatëse të emërimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve me institucionin si më poshtë:
1. Të anulojë urdhrin nr. 81 prot., datë 29.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Zyrën e Apelit të Taksave Vendore.
  2. Të anulojë urdhrin nr. 146 prot., datë 17.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
  3. Të anulojë urdhrin nr. 433 prot., datë 15.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
  4. Të anulojë urdhrin nr. 478 prot., datë 23.06.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
  5. Të anulojë urdhrin nr. 562 prot., datë 07.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
  6. Të anulojë urdhrin nr. 398 prot., datë 11.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste (Juriste)”, në Sektorin e Njesisë së Prokurimeve, në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.
  7. Të anulojë urdhrin nr. 1214 prot., datë 15.12.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Investimeve”, në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.
  8. Të anulojë urdhrin nr. 1230 prot., datë 21.12.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Investimeve, në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.
  9. Të anulojë urdhrin nr. 189 prot., datë 29.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Preventimit, Hartimit dhe Përcaktimit të Kriteve dhe Specifikimeve Teknike, në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.
  10. Të anulojë urdhrin nr. 442 prot., datë 16.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Preventimit, Hartimit dhe Përcaktimit të Kriteve dhe Specifikimeve Teknike në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.
  11. Të anulojë urdhrin nr. 695 prot., datë 11.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste (Juriste)”, në Drejtorinë e Informacionit.
  12. Të anulojë urdhrin nr. 117 prot., datë 09.03.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Informimit Qytetar”, në Drejtorinë e Informacionit.
  13. Të anulojë urdhrin nr. 741 prot., datë 16.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.
  14. Të anulojë urdhrin nr.773 prot., datë 17.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Infrastrukturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.
  15. Të anulojë urdhrin nr. 674 prot., datë 03.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikës Ligjore dhe Lejet e Përdorimit”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.

16. Të anulojë urdhrin nr. 644 prot., datë 11.09.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist”, në Drejtorinë e Projekteve dhe Shërbimeve  
Inxhinierike.
17. Të anulojë urdhrin nr. 139 prot., datë 27.03.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (ing. Elektrik)”, në Drejtorinë e Projekteve  
dhe Shërbimeve Inxhinierike.
18. Të anulojë urdhrin nr. 176 prot., datë 23.02.2016, për emërimin e Aqif  
\*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist”, në Drejtorinë e Projekteve  
dhe Shërbimeve Inxhinierike.
19. Të anulojë urdhrin nr. 195 prot., datë 26.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (ing)”, në Drejtorinë e Projekteve dhe  
Shërbimeve Inxhinierike.
20. Të anulojë urdhrin nr. 196 prot., datë 26.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (ing)”, në Drejtorinë e Projekteve dhe  
Shërbimeve Inxhinierike.
21. Të anulojë urdhrin nr. 734 prot., datë 16.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist”, në Drejtorinë e Projekteve dhe Shërbimeve  
Inxhinierike.
22. Të anulojë urdhrin nr. 975 prot., datë 22.10.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë Detyrave të  
Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
23. Të anulojë urdhrin nr. 970 prot., datë 22.10.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Drejtorinë e Detyrave të Projektim  
Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
24. Të anulojë urdhrin nr. 85 prot., datë 01.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Jurist”, në Drejtorinë e Detyrave të Projektim  
Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
25. Të anulojë urdhrin nr. 1200 prot., datë 07.12.2015, për emërimin e  
\*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (Topograf)”, në Drejtorinë e  
Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
26. Të anulojë urdhrin nr. 69 prot., datë 29.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (Topograf)”, në Drejtorinë e Detyrave të  
Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
27. Të anulojë urdhrin nr. 659 prot., datë 05.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (Topograf)”, në Drejtorinë e Detyrave të  
Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
28. Të anulojë urdhrin nr. 729 prot., datë 16.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist (Topograf)”, në Drejtorinë e Detyrave të  
Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.
29. Të anulojë urdhrin nr. 175 prot., datë 23.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Drejtores”, në Drejtorinë e Administratës dhe Burimeve  
Njerëzore.
30. Të anulojë urdhrin nr. 465 prot., datë 23.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialiste (Juriste)”, në Sektorin e Menaxhimit të  
Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Administratës dhe Burimeve Njerëzore.
31. Të anulojë urdhrin nr. 523 prot., datë 01.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve  
Njerëzore, në Drejtorinë e Administratës dhe Burimeve Njerëzore.
32. Të anulojë urdhrin nr. 158 prot., datë 01.04.2015 për emërimin e \*\*\*\*\*  
në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Përfaqësimit në Gjykatë, në  
Drejtorinë Juridike.

33. Të anulojë urdhrin nr. 87 prot., datë 01.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Jurist", në Sektorin e Përfaqësimit në Gjykatë, në Drejtorinë Juridike.
34. Të anulojë urdhrin nr. 513 prot., datë 31.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Jurist", në Sektorin e Përfaqësimit në Gjykatë, në Drejtorinë Juridike.
35. Të anulojë urdhrin nr. 759 prot., datë 25.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Jurist", në Sektorin e Përfaqësimit në Gjykatë, në Drejtorinë Juridike.
36. Të anulojë urdhrin nr. 597 prot., datë 19.08.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, "Specialiste Arkiv Protokoll", në Drejtorinë Juridike.
37. Të anulojë urdhrin nr. 149 prot., datë 17.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit dhe Karrierës", në Drejtorinë e Administratës dhe Burimeve Njerëzore.
38. Të anulojë urdhrin nr. 546 prot., datë 07.08.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Drejtor", në Drejtorinë e Koordinimit me Njesitë Administrative.
39. Të anulojë urdhrin nr. 560 prot., datë 10.08.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist", në Drejtorinë e Koordinimit me Njesitë Administrative.
40. Të anulojë urdhrin nr. 685 prot., datë 09.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist", në Drejtorinë e Koordinimit me Njesitë Administrative.
41. Të anulojë urdhrin nr. 545 prot., datë 12.08.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Drejtores", në Drejtorinë e Financës.
42. Të anulojë me urdhrin nr. 248 prot., datë 29.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste", në Sektorin e Kontrollit Financiar, në Drejtorinë e Financës.
43. Të anulojë urdhrin nr. 827 prot., datë 05.10.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës "Specialist-Inventarizues", në Drejtorinë e Financës.
44. Të anulojë urdhrin nr. 361 prot., datë 07.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Drejtores", në Drejtorinë e Aseteve, Pronave e Strehimit.
45. Të anulojë urdhrin nr. 451 prot., datë 17.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Përgjegjëse e Sektorit të Strehimit", në Drejtorinë e Aseteve, Pronave e Strehimit.
46. Të anulojë urdhrin nr. 765 prot., datë 22.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste", në Sektorin e Strehimit, në Drejtorinë e Aseteve, Pronave e Strehimit.
47. Të anulojë urdhrin nr. 746 prot., datë 23.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste", në Sektorin e Pronave, në Drejtorinë e Aseteve, Pronave e Strehimit.
48. Të anulojë urdhrin nr. 717 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialiste Juriste", në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik.
49. Të anulojë urdhrin nr. 1193 prot., datë 07.12.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist IT", në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik.
50. Të anulojë urdhrin nr. 512 prot., datë 31.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, "Specialist IT", në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik.

51. Të anulojë urdhrin nr. 788 prot., datë 22.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Programeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
52. Të anulojë urdhrin nr. 391 prot., datë 03.07.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Programeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
53. Të anulojë urdhrin nr. 802 prot., datë 25.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektori e Ndhmës Ekonomike”, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
54. Të anulojë urdhrin nr. 1227 prot., datë 15.12.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
55. Të anulojë urdhrin nr. 1226 prot., datë 15.12.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
56. Të anulojë urdhrin nr. 642 prot., datë 29.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
57. Të anulojë urdhrin nr. 671 prot., datë 04.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Trashëgimisë Kulturore, në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Rinisë e Sporteve.
58. Të anulojë urdhrin nr. 705 prot., datë 11.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Sportit, në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Rinisë e Sporteve.
59. Të anulojë urdhrin nr. 3 prot., datë 06.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor”, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
60. Të anulojë urdhrin nr. 40 prot., datë 20.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektorit Arsimit Parashkollor”, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
61. Të anulojë urdhrin nr. 38 prot., datë 20.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
62. Të anulojë urdhrin nr. 355 prot., datë 07.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
63. Të anulojë urdhrin nr. 124 prot., datë 12.03.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Edukimit Rinor, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
64. Të anulojë urdhrin nr. 461 prot., datë 21.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Edukimit Rinor, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit.
65. Të anulojë urdhrin nr. 379 prot., datë 09.03.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Infrastrukturore.
66. Të anulojë urdhrin nr. 559 prot., datë 07.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor”, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban.
67. Të anulojë urdhrin nr. 140 prot., datë 27.03.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist” në Sektorin e Sipërfaqeve Urbane dhe Emergjencave, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban.

68. Të anulojë urdhrin nr. 637 prot., datë 01.09.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban.
69. Të anulojë urdhrin nr. 54 prot., datë 25.01.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban.
70. Të anulojë urdhrin nr. 119 prot., datë 10.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
71. Të anulojë urdhrin nr. 713 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori Vlerësimit dhe Përballimit”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
72. Të anulojë urdhrin nr. 719 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
73. Të anulojë urdhrin nr. 537 prot., datë 05.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
74. Të anulojë urdhrin nr. 720 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
75. Të anulojë urdhrin nr. 714 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
76. Të anulojë urdhrin nr. 531 prot., datë 01.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
77. Të anulojë urdhrin nr. 525 prot., datë 01.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
78. Të anulojë urdhrin nr. 718 prot., datë 12.05.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Sektorin e Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit, në Drejtorinë e Emergjencave Civile.
79. Të anulojë urdhrin nr. 847 prot., datë 13.10.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist”, në Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore, Blegtoriale, Tokave e Pyjeve.
80. Të anulojë urdhrin nr. 199 prot., datë 16.02.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektore” në Inspektoriatin e Mjedisit.
81. Të anulojë urdhrin nr. 206 prot., datë 05.05.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialist i Urbanistikës, Lagjja Nr. 1 dhe Nr. 2”.
82. Të anulojë urdhrin nr. 1206 prot., datë 09.12.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, Lagjja Nr. 2”.
83. Të anulojë urdhrin nr. 12 prot., datë 13.01.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, Lagjja Nr 2”.
84. Të anulojë urdhrin nr. 390 prot., datë 02.07.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, Lagjja Nr. 3”.
85. Të anulojë urdhrin nr. 548 prot., datë 06.04.2016, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, Lagjja Nr. 6”.
86. Të anulojë urdhrin nr. 640 prot., datë 11.09.2014, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, Lagjja Nr. 6”.
87. Të anulojë urdhrin nr. 864 prot., datë 09.10.2015, për emërimin e \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialiste e Urbanistikës, Lagjja Nr. 5 e 6”.

- *Fillimisht të vlerësohet mundësia e sistemimit të punonjësve të evidentuar në pikën 7, të këtij vendimi, në vendet e lira të krijuara pas ndërprerjes së marrëdhënies financiare të punonjësve të përmendur në këtë pikë të vendimit.*
- *Pozicionet e mësipërme të punës duhet të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, 23, 24, e vijues të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në përputhje me dinamikën dhe nevojat që paraqet struktura aktuale e institucionit, apo ajo që pritet të miratohet.*

*Njësia përgjegjëse, duhet të veprojë në koherencë me situatën që do të rezultojë pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit. Për punonjësit që do të përfitojnë statusin e nëpunësit civil, duhet të bëhet emërimi, pa konkurrim, nëse i plotësojnë kërkesat për një nga këto pozicione pune në shërbimin civil.*

- 12.** *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë lidhur me mangësitë e konstatuara në administrimin e shërbimit civil, për rastet e punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , në këtë mënyrë:*
  - *Për nëpunësin \*\*\*\*\* , duhet të plotësojë menjëherë dosjen e personelit me formularin e vlerësimit të punës dhe të nxjerrë aktin e pezullimit nga shërbimi civil, sipas kërkesave të neneve 53, deri 56, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për shkak të kalimit në funksion politik.*
  - *Për nëpunësin \*\*\*\*\* , duhet të administrojë menjëherë në dosjen e personelit, aktin e njehsimit të diplomës (Bachelor), sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe rregullave të parashikuara në ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, pasi e ka kryer arsimin jashtë shtetit.*
- 13.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, në kushtet e riorganizimit të institucionit, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe Lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".*
- 14.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procesin e vlerësimeve të rezultateve të punës të punonjësve sipas legjislacionit të shërbimit civil, në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil".*
- 15.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, të hartojë planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", për vitin në vijim.*

- 16.** *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijoni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

**Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II.** Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
  2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

**Enkelejda HEBIBASI**